

RREGULLORE
ANKESA DHE KORRIGJIME
MEDIA AMFORA

QERSHOR, 2022

Ankesa dhe korrigjime:

Media Amfora është e hapur për t'u angazhuar me audiencën dhe për t'u marrë me komentet dhe ankesat legjitime. Kjo rregullore ka për qëllim informimin e publikut për rregullat dhe procedurat që do të ndiqen nga Media Amfora për trajtimin e ankesave dhe së drejtës për përgjigje nga publiku. Çdo person që kërkon të ushtrojë të drejtat e mësipërme përpara se t'i drejtohet Medias Amfora duhet të bëjë evidentimin e qartë nëse ka një ankesë për krijimet e publikuara apo nëse kërkon të ushtrojë të drejtën për përgjigje.

Ndërveprimi ynë renditet sipas kushteve më poshtë:

A. ANKESA:

1. Media Amfora do të shqyrtojë çdo ankesë të arsyetuar, të paraqitur me shkrim nga çdo person për krijimet e publikuara prej saj. Ankesa duhet të përmbajë të dhëna të rëndësishme, për fakte dhe rrethana mbi cenimin nga ana jonë dhe nuk duhet t'i kalojë 500 fjalë, ndërsa një dokument me argumente mund të dërgohet i bashkëlidhur si fakte mbështetëse;

2. Ankesa duhet të paraqitet në përputhje me formularin e ankesës i cili duhet të përmbajë minimalisht këto elemente:

a. Të dhëna mbi ankuesin, të identifikuar në mënyrë të qartë;

b. Përshkrimin e shkeljeve të supozuara apo rrethanave konkrete të pretenduara, datën e publikimit të krijimit.

2.1 Formulari i ankesës mund të shkarkohet në faqen e internetit të Medias Amfora (www.amfora.al), rubrika “Ankesa dhe Korrigjime” dhe duhet të paraqitet në adresën e postës elektronike: amfora.al@gmail.com

3. Në rast se ankesa nuk paraqitet sipas formularit të ankesës dhe nuk i përmbush kriteret formale të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, si më sipër Media Amfora brenda 2 ditëve nga mbërritja e ankesës kërkon plotësimin e mangësive të ankesës. Në rast mosplotësimi të mangësive brenda këtij afati kohor, Media Amfora do të refuzojë shqyrtimin e ankesës së depozituar;

4. Media Amfora e shqyrton ankesën e depozituar brenda 5 ditësh pune nga paraqitja e saj;

5. Kërkesa për publikimin e ankesës duhet të paraqitet tek Media Amfora brenda 30 ditëve nga dita e publikimit të krijimit, të cilit i adresohet kjo kërkesë;

6. Media Amfora i kthen përgjigje ankuesit brenda 30 ditëve nga marrja e ankesës së paraqitur në përputhje me kriteret formale në pikat 1 dhe 2, për krijimet e publikuara prej saj.

B. KORRIGJIME:

1. Çdo person fizik apo juridik, dinjiteti dhe reputacioni i të cilit janë prekur nga publikimi i fakteve dhe informacioneve jo të sakta në një publikim të Medias Amfora, ka të drejtën e përgjigjes (replikës);
2. Media Amfora do të shqyrtojë çdo kërkesë për korrigjim të arsyetuar, të paraqitur me shkrim nga çdo person për krijimet e publikuara prej saj. Ajo duhet të përmbajë të dhëna të rëndësishme, për fakte dhe rrethana mbi pasaktësitë nga ana jonë dhe nuk duhet t'i kalojë 500 fjalë, ndërsa një dokument me argumente mund të dërgohet i bashkëlidhur si fakte mbështetëse;
3. Ankesa duhet të paraqitet në përputhje me formularin e ankesës dhe kërkesës për korrigjim, i cili duhet të përmbajë minimalisht këto elemente:
 - a. Të dhëna mbi ankuesin, të identifikuara në mënyrë të qartë;
 - b. Përshkrimin e shkeljeve të supozuara apo rrethanave konkrete të pretenduara, datën e publikimit të krijimit dhe se cilat elementë kërkohet të korrigjohen;
- 3.1 Formulari i kërkesës për korrigjim mund të shkarkohet në faqen e internetit të Medias Amfora (www.amfora.al), rubrika “Ankesa dhe Korrigjime” dhe duhet të paraqitet në adresën e postës elektronike: amfora.al@gmail.com
- 3.2 Në rast se ankesa nuk paraqitet sipas formularit të ankesës dhe nuk i përmbush kriteret formale të përcaktuara në pikat 2 dhe 3, si më sipër Media Amfora brenda 2 ditëve nga mbërritja e ankesës kërkon plotësimin e mangësive të ankesës. Në rast mosplotësimi të mangësive brenda këtij afati kohor, Media Amfora do të refuzojë shqyrtimin e ankesës së depozituar;
4. Personi që kërkon të drejtën e përgjigjes duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim, drejtuar Medias Amfora, duke parashtruar arsyet dhe faktet me të cilat provon pretendimin e tij. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet çdo dokument që vërteton pretendimet e personit që kërkon të drejtën e përgjigjes.

Kërkesa duhet të paraqitet në adresën elektronike: amfora.al@gmail.com
5. Kërkesa për të drejtën e përgjigjes duhet të paraqitet tek Media Amfora brenda 30 ditëve nga dita e publikimit të krijimit, të cilit i adresohet kjo kërkesë;
6. Media Amfora brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës vendos për ushtrimin ose refuzimin e së drejtës së përgjigjes, duke e njoftuar me shkrim kërkesin lidhur me vendimin e marrë si më sipër.

Media Amfora mund të refuzojë të drejtën e përgjigjes kur:

- a) Vlerëson se ajo është abuzive dhe e pabazuar, apo e bërë në keqbesim;
- b) E drejta e kërkuar për përgjigje është opinion personal i personit dhe s'ka të bëjë me rregullimin e ndonjë lajmi me karakter fakti apo informacioni;
- c) E drejta e kërkuar për përgjigje përmban parashtrimin e fakteve dhe informacioneve të rreme;
- d) E drejta e kërkuar për përgjigje është bërë për të kërkuar parandalimin e veprimeve të pritshme apo që s'kanë ndodhur ende;
- e) Përmbushja e së drejtës për përgjigje përfshin një ndëshkim, kapërcen rregullat e mirësjelljes, apo sjell dënimin e ofruesit të shërbimit mediatik në një proces gjyqësor civil;
- f) Personi i dëmtuar nga informacioni i kundërshtuar nuk ka interes të ligjshëm në momentin e kërkesës për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes;
- g) Transmetimi i kundërshtuar përmban një thënie apo deklaram të personit të prekur, të tillë që konsiderohet i barasvlefshëm me vetë përgjigjen e kërkuar ose kur personi ka dhënë pëlqimin paraprak në një mënyrë formale lidhur me përmbajtjen e transmetimit;
- h) Një korrigjim i barasvlefshëm i të dhënave të informacionit të kundërshtuar është bërë paraprakisht dhe për këtë është njoftuar personi i prekur;
- i) Përmbajtja e përgjigjes së kërkuar dhunon të drejtat e një pale të tretë;
- j) Çështja objekt ankese lidhet me thëniet gjatë veprimtarive parlamentare, zhvillimit të seancave gjyqësore apo transmetimit të veprimtarive të subjekteve politike;
- k) Transmetimi i së drejtës për përgjigje nuk është në interes të publikut;
- l) Kërkesa është paraqitur në tejkalim të afatit;
- m) Kërkesa është paraqitur në mënyrë anonime.

7. Nëse brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, kërkuesi nuk merr një përgjigje, prezumohet se Media Amfora e ka refuzuar kërkesën;

8. Nëse Media Amfora vendos për ushtrimin e të drejtës së përgjigjes nga personi që e ka kërkuar, ai duhet ta publikojë përgjigjen brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës;

E drejta e përgjigjes duhet të paraqesë se në çfarë mase informacioni i paraqitur në krijim është jo korrekt dhe mashtrues dhe të kufizohet në pohimin e fakteve të nevojshme për korrigjimin e fakteve apo informacioneve të pavërteta;

13. Për realizimin e kërkesës së ushtrimit të së drejtës së përgjigjes Media Amfora nuk do të aplikojë asnjë lloj tarife.